



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni Pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme
Mbledhja nr. 3
Prishtinë, më 30 mars 2011, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

P r o c e s v e r b a l

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Albin Kurti, Hydajet Hyseni, Enis Kervan, Shaip Muja, Skender Hyseni, Sabri Hamiti, Donika Kadaj-Bujupi, Amir Ahmeti, dhe Petar Miletic.

Pjesëmarrës të tjerë: Abi Dodbiba – ECLO, Tiina Benreljem - ECLO, Besnik Ramadani – KDI dhe Floriana Shala – OSBE.

Nga Zyra e Komisionit: Minire Hasani, Manush Krasniqi dhe Elfete Alshiqi - praktikante.

Mbledhjen e kryesoi: Albin Kurti - kryetar i Komisionit.

R E N D I I D I T Ë S

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të datës 23 mars 2011;
3. Njoftim nga ministri Enver Hoxhaj lidhur me buxhetin e Ministrisë së Punëve të Jashtme;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i planit dhe i programit të punës së Komisionit për vitin 2011;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Komisioni e miratoi rendin e ditës me heqjen e pikës së tretë nga rendi i ditës, në mungesë të ministrit Hoxhaj, për shkak të angazhimeve të tij lidhur me Konferencën e Parë të Ambasadorëve, që do të mbahet më 30 mars 2011.

2. Miratimi i procesverbalit të datës 23 mars 2011

Komisioni e miratoi procesverbalin e datës 23 mars 2011 me vërejtjen e deputetit Amir Ahmetit, se fjalët: **“Nga një takim i mëparshëm me ministrin e jashtëm njoftoj se ka informatë”**, zëvendësohen me: **“Nga një takim i GP të KKR, me ministrin e financave jemi njoftuar”**, si dhe me vërejtjen e deputetit Shaip Muja se në diskutimin e tij të parë pas fjalëve: **“ministri i**

Punëve të Jashtme të shtohen fjalët “**dhe ministri i Financave**”. Njëkohësisht z. Muja njoftoi se ministri Enver Hoxhaj do të jetë prezent në mbledhje të Komisionit, pas 15 minutave.

Hydajet Hyseni - Propozoi që në procesverbal të përfshihen vetëm: pjesëmarrësit, rendi i ditës diskutuesit, propozimet dhe përfundimet e Komisionit, me qëllim të evitimit të interpretimeve të lira të diskutimeve, sepse nuk ka mundësi të përfshihen gjitha diskutimet.

Komisioni u dakordua që do të vazhdojë punën edhe me pikën e tretë të rendit të ditës, posa të arrijë ministri Enver Hoxhaj.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i planit dhe i programit të punës së Komisionit për vitin 2011

Albin Kurti - Të gjithë deputetëve u është shpërndarë për shqyrtim dhe miratim një propozim i planit dhe i programit të punës së Komisionit për vitin 2011. Është kërkesë e Kryesisë së Kuvendit që planet dhe programet e komisioneve të hartohen deri më 31 mars. Në planin dhe në programin e punës së Komisionit, sipas muajve, janë të propozuara pikat për shqyrtim nga Komisioni.

Donika Kadaj - Bujupi - Propozoi një draft me shkrim me disa pika për shqyrtim, me qëllim të përfshirjes së tyre në planin dhe në programin e punës.

Sabri Hamiti – I përkrahu në parim propozimin e planit dhe të programit të punës së Komisionit, dhe propozimet e deputetes Donika Kadaj Bujupi. Sugjeroi që të mos insistohet në precizitet të zbatimit të planit dhe të programit në kohën e paraparë, për shkak të mundësisë së lëvizjes së çështjeve për shqyrtim.

Skënder Hyseni - Tha se në draftplanin dhe në programin e punës janë të përfshira të gjitha çështjet që i përkasin Komisionit për objekt shqyrtimi. Pikat e propozuara për program të punës nga deputetja Donika Kadaj - Bujupi janë të qëlluara, ndërsa pika për harmonizimin e legjislacionit ka të bëjë më tepër me Komisionin për Integritet Evropian.

Hydajet Hyseni - Propozoi që Komisioni të përqendrohet në 6-mujorin e parë të planit dhe të programit dhe pastaj të rishqyrtohet 6-mujori i ardhshëm. Propozoi të shqyrtohet Raporti i Progresit i KE-së nga këndvështrimi i Komisionit dhe praktika e ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare në vendin tonë. I përkrahu propozimet e deputetes Donika Kadaj Bujupi. Propozimi për organizimin e debateve me OJQ-të, propozon të zgjerohet edhe me organizimin e konferencave dhe të formave të tjera të komunikimit me partnerë, lidhur me fushën e Komisionit. E përkrahu draftplanin dhe programin e punës së Komisionit.

Shqip Muja - Kërkoi të njoftohet se çka nënkupton pika “Diskutim për iniciimin e një instituti kombëtar të diasporës bashkë me Shqipërinë dhe me Maqedoninë” e paraparë në planin dhe programin e punës së Komisionit.

Albin Kurti - Pika “Diskutimi për iniciimin e një instituti kombëtar të diasporës bashkë me Shqipërinë dhe me Maqedoninë” është propozuar, sepse një numër madh i qytetarëve tanë, po ashtu të Shqipërisë dhe të Maqedonisë jetojnë jashtë vendit. Meqë të gjithë këta qytetarë kanë afërsi dhe bashkëpunojnë jashtë vendit, është propozuar si ide, për të cilën ia vlen të diskutohet, në bashkëpunim me komisionet parlamentare të jashtme të Shqipërisë dhe të Maqedonisë.

Shaip Muja - Një propozim i këtillë është bërë nga Zyra e Kryeministrit të Qeverisë së kaluar dhe nga Agjencia për përfaqësimin e diasporës, por nuk jam i njoftuar deri ku ka mbërritur kjo çështje, cilat janë objektivat dhe planet e tij për t'u funksionalizuar.

Amir Ahmeti - Inicimi i diplomacisë parlamentare propozoi të mbetet objektiv i Komisionit, sa herë që t'i jepet mundësia, gjatë tërë vitit dhe të mos kufizohet në ndonjërin muaj.

Donika Kadaj - Bujupi - Bashkëpunimi me NDI-në është propozuar, sepse këtë vit komisionet parlamentare kanë mbështetje shtesë financiare nga NDI-ja dhe kjo do të mund t'i shërbente Komisionit për ndonjë ekspertizë. Organizimi i debateve për ligje dhe i tryezave me qytetarët do të ishte i mirëseardhur. Propozoi që në të ardhmen të diskutohet çështja e kërkimit të vizave për pasaporta diplomatike që po ndodh për vendin tonë. E përkrahu planin dhe programin e punës së Komisionit, të propozuar për vitin 2011.

Petar Miletij – E përkrahu draftplanin dhe programin e punës së Komisionit, por ceku se mund të ketë lëvizje rreth afateve të përmbushjes së tyre. E propozoi përfshirjen e pikave të propozuara nga deputetja Donika Kadaj - Bujupi, posaçërisht raportimin për procesin e bisedimeve me Serbinë, për të cilin propozoi të jetë periodik.

Skender Hyseni - Njohja e pasaportave dhe e vizave është e rregulluar me Konventat e Vjenës me marrëveshje diplomatike dhe konsullore. Kërkesa për vizë nuk do të thotë mosnjohje e pasaportës diplomatike, sepse janë dy çështje të ndara. Çështja e vizave rregullohet me marrëveshje bilaterale ndërmjet dy vendeve, përkatësisht me marrëveshje shumë palëshe në rastin e Shengenit.

Komisioni pas këtyre diskutimeve nxori këtë

P e r f u n d i m

Miratohet plani dhe programi i punës së Komisionit për Punë të Jashtme për periudhën mars – dhjetor 2011, me pikat e propozuara nga deputetja D. Kadaj-Bujupi për: Takim me përfaqësuesit e organizatave mbështetëse për komisionet parlamentare; Mbikëqyrja dhe shqyrtimi i planit të Qeverisë – veprimet në planin e politikës së jashtme dhe, Organizimin e dëgjimit publik lidhur me Projektligjin për marrëveshjet ndërkombëtare .

4. Njoftim nga ministri Enver Hoxhaj lidhur me buxhetin e Ministrisë së Punëve të Jashtme

Enver Hoxhaj - ministër i MPJ – E shprehu gatishmërinë të jetë i pranishëm në mbledhjet e Komisionit, sa herë që do të ishte e nevojshme. Në diskutimin e tij njoftoi se në MPJ janë marrë dy vendime: njëri për formimin e një strategjie për lobim, që do të përbëhej prej tri pjesëve dhe vendimi tjetër për formimin e një dokumenti për politikë të jashtme, që do t'i përmbante parimet e politikës së jashtme të Republikës së Kosovës. Lidhur me buxhetin, ka qenë një kërkesë e planifikimit buxhetor për vitin 2010 në lartësi prej 36 milionë eurosh. Në debatet e fundit buxhetore është arritur një përfundim, që gjatë këtij viti të mos blihen pjesë të ndërtesave për ambasada, për shkak të nevojës së krijimit të një strategjie të re për blerjen e ambasadave, që duhet diskutuar edhe me Komisionin. Shkurtime buxhetore kanë ndodhur në pjesën e investimeve kapitale si dhe në mallra e shërbime.

Për çështjet e ngritura nga deputetët: S. Hyseni, H. Hyseni, S. Hamiti, A. Ahmeti dhe A. Kurti, ministri **Enver Hoxhaj** tha se pagesa e ambasadorëve e shtruar nga S. Hyseni duhet definuar ndoshta me një udhëzim administrativ. Për blerjen e ambasadave duhet bërë kalkulime të sakta edhe me një

debat në Komision, se ku me të vërtetë kemi nevojë të sigurojmë ndërtesa të reja. Deputetin H. Hyseni e falënderoi për mbështetjen dhe për qasjen e njëjtë të të kuptuarit të politikës së jashtme. Lidhur me pyetjet e deputetit S. Hamiti, ministri njoftoi se çështja e cila më së shumti e atakon MPJ-në është mungesa e 1 milion e gjysmë ose 2 milionë eurosh për mallra e shërbime, që ka të bëjë me lobim-avokim dhe me shumë aktivitete të tjera. Në këtë 2 milionë eurosh nuk ka pasur ndërhyrje nga Ministria e Financave por nga FMN-ja. Ambasadorët tanë janë shërbyes civilë, por shërbyesit civilë të ngarkuar dhe në hierarki, duhet të kenë diferencim të pagave dhe nuk mund të trajtohet njëjtë një punëtorë ambasade, si një ambasador. Në çështjet e ngritura nga kryetari i Komisionit A. Kurti lidhur me programin e Qeverisë, ministri tha se është një program i shkurtër dhe se ka qëndrim kritik ndaj këtij programi. MPJ-ja do ta hartojë një program të aktiviteteve për vitin 2011 – 2014, që do të influencohet nga dokumenti për politikë të jashtme dhe nga strategjia për lobim. Strategjia për lobim është në hartim e sipër. Ajo do të jetë e gatshme në fund të prillit dhe do të jetë në harmoni të plotë me dokumentin për politikë të jashtme. Sa i përket buxhetit që ka të bëjë me pjesën, që është e specifikuar dhe e paspecifikuar, investime kapitale dhe shuma që parashihet në investime kapitale, MPJ-ja ka një parakontratë për blerjen e ambasadës në Bruksel, në vlerë prej 2.4 milion euro, të cilës i dedikohet shuma nga investimet kapitale. MPJ është e interesuar që kontrata për blerjen e ambasadës në Bruksel të mos nënshkruhet, para se Komisioni të njoftohet për të gjitha hollësitë e kësaj kontrate. Qasja e re për lobim dhe shkurtime buxhetore kanë ndikime buxhetore. Jemi të gatshëm të ndajmë organogramin e MPJ-së me Komisionin. Çështja e pajisjeve, mobileve dhe e teknologjisë informative është një ndër problemet më të ndjeshme që i ka MPJ-ja, e po ashtu edhe çështja e hapësirës.

Fitim Gllareva - sekretar në MPJ - Njoftoi për mjetet lidhur me parakontratën për blerjen e ambasadës në Bruksel.

Albin Kuti - Kërkoi të njoftohet nga z. Gllareva se çka përfshin shuma prej 9.2 milionë eurosh dhe se a mund të pajiset Komisioni me ndonjë pasqyrë më të hollësishme, sepse kjo shumë përfshin gati gjysmën e buxhetit të MPJ-së.

Fitim Gllareva - Tha se sipas shpjegimeve nga Ministria e Financave në shumën prej 9.2 milionë eurosh, përfshihet edhe çështja e lobimit në lartësi prej 1.5 milion eurosh.

Enver Hoxhaj - Duke u ndërlidhur me diskutimet e deputetëve Skënder Hyseni, Sabri Hamiti dhe Hydajet Hyseni, ministri tha se MPJ-ja realisht ka nevojë edhe për një rritje të buxhetit që përfshin 1 deri në 2 milion euro, që do të ndihmonte shumë për çështje të lobimit dhe për çështje të tjera. E ndan mendimin me deputetin S. Hyseni dhe me deputetët e tjerë, se është në dispozicion ta njoftojë Komisionin për punën e MPJ-së, por jo edhe çdo gjë të jetë shumë publike. Lidhur me shtimin e vendeve, që na kanë njohur, tha se është i nevojshëm një rimendim për misionet diplomatike, me ç'rast Komisioni do të mund t'i ndihmonte MPJ-së në kontinuitetin dhe ridefinimin e misioneve diplomatike.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Albin Kurti

